



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.125/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e BIRN, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me datë 22.10. 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 06.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**PRANOHET** si e bazuar ankesa e organizatës BIRN, me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 1.500 (njëmijë e pesëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarrimit.

### A r s y e t i m

Organizata BIRN me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 05.10.2017, me të cilën pretendon se Kandidati për Kryetar të Komunës së Prishtinës, nga radhët e subjektit politik LVV, Shpend Ahmeti në spotin e tij në rrjetin social Facebook, ka përdorur fëmijë të mitur. Parashtruesi i ankesës pretendon se me këtë Shpend Ahmeti, kandidat për Kryetar të Komunës së Prishtinës nga radhët e subjektit politik LVV, ka shkelur Kodin e Mirësjelljes .

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur fotografi, nga vendi ku ka ndodhur shkelja e kodit të mirësjelljes për subjekte politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët.

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik LVV, të datës 06.10.2017, theksoi se Subjekti politik LVV gjatë vizitës në KB Prishtina në asnjë rrethanë nuk kanë mundur të din se në mesin e klubit mund të ketë persona nën moshën 18 vjet, dhe se publikimi i këtyre fotografive nuk ka pasur për qëllim keqpërdorimin e fëmijëve ashtu siç pa bazë pretendohet në ankesën e BIRN-it. Pas pranimit të urdhrorit për përmirësim, LVV kanë ndërmarrë masat përmirësuese, duke larguar fotografit e postuara në rrjetin social facebook, dhe për të dëshmuar evitimin e shkeljes, përgjigjes i kanë bashkangjitur 4 fotografi.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

## **Ankesa është e bazuar**

Paneli nga fotografitë ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se Shpend Ahmeti, kandidat për Kryetar të Komunës së Prishtinës, nga radhët e subjektit politik LVV, është bërë shkelja e Kodit të Mirësjelljes, nga fakti se, kandidati në fjalë ka bërë fushatë në objekt publik, veprime këto të sanksionuara me dispozitën e nenit 35.1 të LZP-së, e cila përcakton: *“Personi që mban pozitë publike, i zgjedhur apo i caktuar, nuk mund të përdorë atë zyrë ose ndonjë nga pasuritë e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike, qoftë i nivelit qendror ose lokal, ose edhe ndonjë ndërmarrje në zotërim ose e kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale, nuk mund të shfrytëzohen ose futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje”*

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje LVV, nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se e njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen ka mohuar shkeljen e supozuar. Pretendimet në ankesë nga ana e panelit janë vlerësuar si pa ndikim në marrjen e vendimit më të favorshëm për subjektin në fjalë. Ndërsa, veprime që kanë ndërmarrë për të bërë përmirësimin e shkeljes nga Paneli janë vlerësuar pozitivisht dhe me ndikim në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi. Paneli po ashtu vlerësoi dënimi i shqiptuar ndaj subjektit në fjalë do të ndikon që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Zl.Anr. 125/2017 më datën 06.10.2017

**Kryesuesi i Panelit**

**Rafet Haxhaj**

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.

